



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 464/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Avdi Smajlaj, sekretar i Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për shkak të vendosjes së njoftimeve, pllakateve dhe posterëve mbi rrugë publike, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Aleanca Kosova e Re

A r s y e t i m

Subjekti politik AKR, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, në ankesë theksohet se LDK ka vendosur postera lidhur me fushatën zgjedhore në afërsi të shkollës.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik AKR, në të cilën theksohet se subjekti politik LDK ka vendosur postera lidhur me fushatën zgjedhore në ndërtesë publike-shkollë.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi, në të cilat shihet qartë se posterat e subjektit politik LDK, janë të vendosur mirëpo nga ankesa e parashtruar nuk kuptohet se në cilin vend dhe në cilën kohë ka ndodhur shkelja.

Rregulla dhe Procedurat e PZAP-it neni 3.6 pika b dhe c parashohin:

b)një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

c)hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat lëndës gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar**

Duke e shqyrtuar ankesën e AKR-së përfundojmë se ankesa në fjalë ka mungesë të provave dhe të përshkrimit të hollësishëm lidhur me atë se në cilën kohë dhe vend ka ndodhur shkelja e pretenduar nga ana e LDK-së, dhe se fotot e ofruara si provë nuk japin ndonjë dëshmi bindëse për shkeljen e pretenduar.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 464/2010 më datën 13.12.2010

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

